

Në bazë të nenit 22, paragrafi 5 dhe nenit 36 nga Ligji për vetëqeverisje lokale („Gazeta zyrtare e RM“, nr. 05/02) dhe nenit 7 nga Ligji për kulturë – tekst i spastruar („Gazeta zyrtare e RM“, nr. 66/03) Këshilli i Komunës së Kumanovës, në mbledhjen e mbajtur më 02 korrik 2009 miratoi

## **P R O G R A M I N**

### **P Ë R K U L T U R Ë N Ë K O M U N Ë N E K U M A N O V Ë S P Ë R P E R I U D H Ë N 2 0 0 9 - 2 0 1 3**

#### **HYRJE:**

1. Me ligjin për vetëqeverisje lokale janë verifikuar kompetencat e vetëqeverisjes lokale nga sfera e kulturës dhe janë definuar si: përkrahje institucionale dhe financiare e institucioneve dhe projekteve kulturore, kultivim i folklorit, zakoneve, zejeve të vjetra dhe vlerat e tjera të ngjajshme kulturore, organizimi i manifestimeve kulturore, nxitja e formave të ndryshme specifike të krijimtarisë.

Me këtë Program verifikohet interesi lokal i kulturës, adekuat me specifikat dhe nevojat zhvillimore të bashkësisë lokale – Komunës së Kumanovës dhe, njëkohësisht, kompatibil me qëllimet, strategjinë, prioritetet e veçanta dhe të përgjithshme të cilat kanë të bëjnë me bashkësitë lokale, e të cilat janë të verifikuara me Ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjin për kulturë dhe ligjet e veçanta nga sferat e veçanta të kulturës.

#### **PRINCIPET DHE QËLLIMET:**

- I. Duke e kuptuar kulturën në bashkësinë lokale si sistem të hapur dhe në kontinuitet, i cili mbështetet mbi traditën, por gjithashtu luan edhe rol të mbindërtimit të realitetit aktual me realizime dhe vlera të reja, ajo ndërtohet mbi disa principe themelore: qasje, llojllojshmëri, qasje të hapur, përgjegjësi dhe fleksibilitet.

**QASJA** paraqet princip i cili mundëson që realizimi i të drejtave kulturore të ketë qasje për të gjithë qytetarët e Komunës dhe më gjërë.

Qasja mund të bëhet kundërproduktive në rastet e implementimit të prezencës, shkallës më të lartë të interesit për përmbajtjet kuazi - kulturore, gjatë së cilës socializimi i tillë i kulturës, jo rrallë herë, i promovon shundet dhe kështu si fenomen masovik shoqëror. Për këtë shkak, principi i qasjes, është i nevojshëm të realizohet për oferta kualitative kulturore, me qëllim që ato të mos komunikojnë me sferë të kufizuara të publikut apo elitizmit, por do të sigurohet alternativë më kualitative dhe më racionale, ende mjaft prezente në praktikë, jokuatitet në jetën kulturore.

**Llojllojshmëria** si princip i shpreh përvojat dhe vlerat e ndryshme të individit, të grupeve sociale dhe të identitetit të bashkësive etnike në Komunë si multietnike, e me këtë edhe mjedisin multikulturor. Njëkohësisht llojllojshmëria ka për qëllim evitimin e standardizimit dhe mesatarizimit e përmbajtjeve kulturore, rrezikun që ato të ngjajnë në prodhime serike industriale dhe si të tilla, surrogat, përkundër nevojës nëpërmjet tyre të shprehet interesi autentik për vlerat e vërteta dhe njohshmërinë, nëpërmjet kulturës së identitetit individual, grupor dhe nacional. Divergjencia e tyre është e nevojshme vetëm nëse mendimi i realizimit të tyre është mbirja e ndërsjelltë e tyre dhe sinteza krijuese, si kualitet i ri. Llojllojshmëria, përveç se në pjesën përmbajtësore, është e nevojshme edhe në format shprehëse të ofertës kulturore, ku vend të veçantë zënë manifestimet kulturore me karakter adekuat ose multimedial.

**Qasja e hapur** i pamundëson rreziqet që jeta kulturore në Komunë të zhvillohen sipas konceptit të mbyllur, sistemit retrograd. Ky princip krijon ura lidhëse dhe komunikim me vlerat kulturore të mjedisve tjera, në nivel nacional dhe ndërkombëtar.

**Përgjegjësia** është princip i cili krijon standarde të përgjegjësisë së misionit kulturor, standarde të zbatimit të principeve dhe kriterëve, të kualitetit, të përdorimit racional të mjeteve në implementim dhe standarde të evaluimit.

**Fleksibiliteti** si princip nënkupton koncept të kyçjes së subjekteve të ndryshme në realizimin e programeve dhe projekteve kulturore, e jo vetëm institucionet profesionale, si dhe qasje fleksibile, me qëllim të kyçjes më të madhe të pjesëmarrësve në krijimin e ofertës kulturore mbi baza vullnetare (OJQ, ndividë e tj.). Madje, sigurimin e modeleve të ndryshme të angazhimit të përbashkët ndërmjet të gjitha subjekteve mbi përmbajtjet e fokusuara dhe produktive kulturore, në masë të vërtetë, mund të sigurojë shkallë të lartë të racionalizimit dhe kualitetit të jetës kulturore, pasi që në atë mënyrë bëhet sintezimi i resurseve të ndryshme me qëllim të përbashkët (psh.: nëse institucionet profesionale disponojnë me objekte, hapsira, pajisje etj), subjektet tjera ndoshta kanë iniciativa kreative ose resurse tjera inovative).

- II. Duke i zbatuar principet si model efikas në organizimin e bashkësisë në sferën e jetës kulturore, përmbajtjet dhe format e krijimtarisë kulturore dhe prezentimit (oferta kulturore), në bashkësinë lokale kanë disa qëllime strategjike.

**Decentralizimi** i kulturës është qëllimi kryesor dhe imperativ i zhvillimit demokratik të shoqërisë. Decentralizimi i kulturës, kuptuar si sinonim i demokratizimit të shoqërisë, me plotë kuptimin e fjalës, mundëson zbatim të interesit të drejtëpërdrejtë të qytetarëve të Komunës në sferën e kulturës. Në këtë pikëpamje, qytetarët kanë pjesëmarrje të barabartë edhe si krijues edhe si konsumues.

Për relizimin e këtij qëllimi është i nevojshëm përfundim i mëtutjeshëm institucional i kulturës në Komunë, shkallë më të lartë të disperzimit të projekteve kulturore nga qendrat e mëdha kulturore në Komunë, si dhe koncept i përpunuar i zhvillimit dhe disperzimi i përmbajtjeve kulturore të qytetit të Kumanovës në mjediset rurale të komunës.

Realizimi i **kulturës si komponentë zhvillimore** e reproduktimit ekonomik dhe shpirtëror të bashkësisë, e jo me trajtim të konsumimit shoqëror është gjithashtu qëllim i rëndësishëm. Kultura si resurs për zhvillimin e bashkësisë lokale kërkon implementim të konceptit të saj më të gjërë, para se gjithash, si mënyrë e përmirësimit të kualitetit të jetesës dhe raport ndaj të gjitha të mirave natyrore – shoqërore. Në këtë kontekst, iniciativat ekologjike, estetizimi i hapsirës urbane dhe hapsirës tjetër, turizmi kulturor dhe sfera të ngjajshme ende nuk janë të kyçura në projektet kulturore e posaçërisht mungon imputi i rëndësishëm për partneritetin lokal ndërmjet subjekteve në kulturë, sektorit – afarist dhe sektorit joqeveritar.

Ky qëllim në masë të madhe mund të realizojë potenciale të gjërë në bashkësinë tonë lokale dhe pikërisht nëpër punktet themelore në interes të Komunës, e këto janë: kultivimi i trashigimisë kulturore, folklorit, traditës, zakoneve dhe zejeve të vjetëra.

Njëra nga qëllimet primare të secilës strategji për zhvillim është **nevoja kulturore e të rinjëve**. Përkrahja e vetëqeverisjes lokale ndaj programeve dhe projekteve kulturore nga dhe për të rinjtë paraqet prioritet të rëndësishëm, gjatë kësaj siguron trajtim adekuat edhe për ofertën kulturore për moshat e tjera dhe shtresat e tjera të qytetarëve.

Vend të posaçëm në krahasim me zhvillimin e kulturës për të rinjtë paraqet përkrahja e krijimtarisë kulturore e të rinjëve dhe përkrahja në afirmimin e talentëve të rinjë të Komunës në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtarë.

## **PRIORITETE TE PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA**

Në bazë të qëllimeve që i ka kultura në bashkësinë lokale, verifikohen proritetet e përgjithshme dhe të veçanta të cilat paraqesin bazë të kriterëve për përkrahjen e vetëadministrimit lokal të programeve dhe proekteve kulturore.

### **1. Prioritetet e përgjithshme**

- a) Implementimi i decentralizimit në kulturë,
- b) Afirmimi i identitetit kulturor të bashkësisë në komunë,
- c) Përkrahja e balancuar e krijimtarisë kulturore dhe prezentimit kulturor, në dallimin e llojeve – formave dhe përmbajtjeve të programeve dhe projekteve kulturore, si dhe qëllimeve të kulturës në Komunë,
- d) Përkrahja e racionalitetit dhe efikasitetit në programet dhe projektet kulturore ndërmjet subjekteve të ndryshme të jetës kulturore.
- e) Qasja e hapur dhe bashkëpunimi në planin kulturor me Komunitat e tjera, në nivel nacional dhe ndërkombëtarë.

### **2. Prioritetet e veçanta**

- a) Përkrahja e programeve dhe projekteve kulturore të institucioneve profesionale në kulturë mbi nivelin institucional të funksionimit të tyre programor,
- b) Përkrahje e programeve dhe projekteve të cilat e kultivojnë folklorin, zakonet , zejjet e vjetëra dhe vlera të ngjajshme kulturore të bashkësisë lokale,
- c) Përkrahje e krijimtarisë kulturore të të rinjëve, të talentëve të rinj të Komunës dhe programet e projektet kulturore të dedikuara të rinjëve.
- d) Përkrahje e manifestimeve kulturore në Komunë (komunale, nacionale dhe ndërkombëtare) të cilat në masë të konsiderueshme e afirmojnë Komunën dhe i implementojnë qëllimet kualitative të kulturës në bashkësinë lokale.

## **PROGRAMET DHE PROEKTET KULTURORE ME INTERES TË VEÇANTË PËR BASHKËSINË LOKALE**

- I. Prioritet në përkrahjen e bashkësisë lokale – Komuna e Kumanovës kanë programet dhe proektet kulturore të cilat i etablojnë vlerat e verifikuara në zhvillimin e kulturës dhe në afirmimin e vlerave dhe identitetit në Komunë.

### **1. Manifestime kulturore**

#### **a) Manifestime kulturore ndërkombëtare**

- **Manifestimi ndërkombëtar i librave „Esetë e Marsit“.**

Mbahet në muajin mars në organizim të Shoqatës për shkencë dhe kulturë „Paradigma“-Kumanovë.

- **Kolonia ndërkombëtare për art figurativ „Kumanova“.**

Mbahet në muajin gusht në organizim të UP Muzeu Kumanovë, kurse nga vitii 2007 në bashkëorganizim me vetëqeverisjen lokale Kumanovë në lokalitetin Qendra Memoriale „ASNOM“ në f. Pelincë.

- **Kolonia ndërkombëtare për art figurativ „Karpino“.**

Mbahet në periudhën korrik-gusht në organizim të Shoqatës së qytetarëve Qendra Multimediale „Karpino“-Kumanovë, në lokalitetin e manastirit „ Karpino “.

- **Xhaz festivali ndërkombëtar i Kumanovës.**

Mbahet në periudhën gusht – shtator në organizim të Shoqatës së qytetarëve „ Xhaz festivali i Kumanovës“ në sheshin e qytetit të Kumanovës.

- **Festivali ndërkombëtar i orkestrit të tamburave ( mandolinave).**  
Mbahet në periudhën gusht – shtator në organizim të Shoqatës së qytetarëve „Tamburashët kumanovar “ - Kumanovë,
- **Festivali ndërkombëtar teatrore „Ditët e komedisë“.**  
Mbahet në muajin tetor në organizim të UP Qendrës për kulturë „Trajko Prokopiev “-Kumanovë.
- **Ekspozita ndërkombëtare e fotografive artistike**  
Mbahet në muajin tetor në organizim të Teknikës popullore – Kumanovë në salonin figurativ të UP Qendrës për kulturë „Trajko Prokopiev “-Kumanovë.

#### **b) Manifestime kulturore në nivel nacional**

- **Festivali folklorik i Romëve „Jekipe Edinstvo“**  
Mbahet me rastin e 8 Prillit Ditës botërore të Romëve në organizim të SHKA „Rushit Shakir“ në sallën e madhe të UP Qendrës për kulturë „Trajko Prokopiev “-Kumanovë.
- **Festivali i baletit modern „MAK DENS“**  
Mbahet në muajin qershor në organizim të UP Qendrës për kulturë „Trajko Prokopiev “-Kumanovë.
- **Festivali i orkestrave frymore nga Republika e Maqedonisë „Roma truba fest“**  
Mbahet gjatë periudhës shtator – tetor në organizim të SHKA „Rushid Shakir“- Kumanovë në Sheshin e Qytetit të Kumanovës.

#### **c) Manifestime kulturore komunale**

- **Manifestimi „Solemnitetet e Buzmit “**  
Mbahet më 6 janar në organizim të Shoqatës së qytetarëve „Therrësit Kumanovar“.
- **Manifestimi „Pivtijada“**  
Mbahet më 19 janar, Ujërat e shenjtë, në organizim të shoqatës së qytetarëve Qendra Multimediale „Karpino“-Kumanovë.
- **Manifestimi maskenbali Kumanovar „Batko Gjorgjija“**  
Mbahet në muajin prill në organizim të vërtetërisjes lokale - Kumanovë më pjesëmarrjen e rinisë shkollore, në Sheshin e Qytetit – Kumanovë.
- **Manifestimi „Cvetnici- kulti tradicional ndaj lules “**  
Mbahet në Cvetnici në organizim të Organizatës së grave „ Kumanovka“ – Kumanovë.
- **Manifestimi „Dita e punëtorëve të arsimit Shqip“**  
Mbahet me rastin e 7 marsit, Dita e punëtorëve të arsimit Shqip në organizim të Shoqatës së qytetarëve - Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë – Kumanovë.
- **Manifestimi „Dita botërore e librit dhe e drejta e autorit “**  
Mbahet me rastin e 23 prillit, Dita botërore e librit dhe e drejta e autorit, në organizim të IPK – Bibliotekës „Tane Georgievski“-Kumanovë.
- **Manifestimi „ Dita e punëtorëve panslloven të arsimit “**  
Mbahet me rastin e 24 majit „Shën Qirili dhe Metodi “-Dita e punëtorëve panslloven të arsimit në organizim të shoqatës së punëtorëve të arsimit – Kumanovë
- **Manifestimi „Vera e kulturës Kumanovare“**

Mbahet në periudhën korrik - gusht, në organizim të vetqeverisjes lokale - Kumanovë në lokalitetet e hapura të qytetit (Kompleksi „Meraku i vjetër“ e tjerë) me disa përmbajtje të veçanta programore dhe në organizim të subjekteve të tjera.

- **Manifestimi „Muaji i librit “**

Mbahet nga 15 tetor deri më 15 nëntor, në organizim të IPK „Tane Georgievski“- Kumanovë me disa përmbajtje të veçanta programore.

- **Manifestimi “Tumba fest”**

Manifestimi i parodive popullore

Organizatorë: Këshilli organizativ i Festivalit.

- **Manifestimi “Takimi i orkestrave frymore”**

Festivali i orkestrave frymore

Organizator: Orkestri frymor “Ilinden” – Kumanovë, Këshilli organizativ i festivalit.

- **Manidesitimi Festivali muzikor i fëmijëve “Fëmijëria lozonjare”**

Organizator: Këshilli organizativ i festivalit

- **Manifestimi “Ditën e Shën Savës”**

Manifestim kulturor

Organizator: Bashkësia Serbe në Maqedoni.

- **Manifestimi “Pensionistët për qytetin e tyre” dhe “Dorështrëngimet e majit”**

Manifestim tradicional i SHKA “Gjoko Simonovski”

Organizator: Shoqata e pensionistëve - Kumanovë.

## **2. Llojet e tjera të programeve dhe proekteve kulturore**

Përkrahja e vetqeverisjes lokale sigurohet për krijimtarinë Kulturo- arstistike dhe Prezentimit kulturo – artistik (forma të veçanta programore – koncepte, shfaqje, ekspozita, promovime etj) në Komunë në sferat e kulturës, muzikës, artit teatral, edukatës figurative, literaturës dhe trashëgimisë kulturore ( folklorit, traditës, zakoneve dhe zejeve të vjetra), mbi prioritetet e përgjithshme dhe të veçanta nga ky Program.

## **3. Shënime - përkujtimore**

Përkrahja e vetqeverisjes lokale sigurohet për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e shënim – përkujtimeve, mbi Programin e posaçëm për shënimin e e ngjarjeve të rëndësishme dhe personave të spikatur me shënim përkujtimor. Me këtë Program rregullohet ndërtimi dhe mirëmbajtja e shënim – përkujtimeve në Komunë (busta, skulptura, pllaka, çeshme dhe fontane, dhe vepra dhe krijime të tjera), që me përmbajtjet dhe shënimet e tyre shënojnë ngjarje dhe persona nga historia dhe kultura e qytetarëve në Komunë nga të gjitha përkatësitë etnike ose nga tradita popullore, që kanë domethënie lokale. Programi për shënim – përkujtimoret sillet për periudhë 5 vjeçare.

## **4. Përkrahja institucionale dhe financiare e institucioneve lokale në kulturë**

Vetëqeverisja lokale siguron përkrahje institucionale dhe financiare të institucioneve lokale për kulturë, në bazë të ligjeve të veçanta dhe të përgjithshme (Ligji për kulturë, Ligji për institucione, Ligji për biblioteka etj) dhe ligjet dhe aktet

nënligjore të cilat e verifikojnë këtë përkrahje (Ligji për finansim të njësisve të vetëqeverisjes lokale, Ligji për buxhetet, Urdhëresat e Qeverisë së RM për blok dhe dotacione dedikuese etj) Përkrahja e institucioneve lokale në kulturë realizohet mbi programet e veçanta për këto institucione dhe pika të posaçme buxhetore të Komunës

Me këtë Program sigurohet përkrahja e programeve dhe proekteve të institucioneve tjera lokale publike nga kultura në Komunë, Të cilat janë mbi nivelin e përkrahjes së tyre institucionale të verifikuara me rregullativën e lartpërmendur, dhe të cilat janë në pajtueshmëri me principet dhe tërësinë, peioritetet e përgjithshme dhe veçanta nga ky Program.

#### **FINANSIMI DHE IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT**

1. Përkrahja finansiare e këtij Programi sigurohet nga Programi K4 - manifestime dhe krijimtari kulturore të Buxhetit të Komunës.
2. Gjatë periudhës së implementimit të tij, Programi është i hapur, kurse përmbajtjet e reja verifikohen me ndryshim dhe plotësim të Programit.
3. Përkrahja finansiare e formave të veçanta programore nga titulli „Programe dhe proekte kulturore me interes të veçantë të bashkësisë lokale“, kapitulli I, pika 2-Lloje tjera të programeve dhe proekteve kulturore, në nivel vjetor, implementohet nëpërmjet konkursit të hapur.
4. Kriteret e veçanta dhe të përgjithshme për përkrahjen finansiare të programeve dhe proekteve kulturore nga ky Program, si dhe mënyra e implementimit të tyre, verifikohen me akt të veçantë.
5. Projekt – Programi vihet në debat publik që do të zgjasë 75 ditë, gjegjësisht deri më 17.09.2009.

Nr.07-6283/3  
02 korrik 2009  
K u m a n o v ë

Këshilli i Komunës së Kumanovës  
Kryetar,  
Viktor Cvetkovski